

RESERVES AND THE COST OF GOODS SOLD**Blerim Shehu**

VTC Prizren, Kosovo, bshehu76@hotmail.com

Abstract: This topic is about the role of stocks of commodities located in the warehouse, these goods are in the form of finished products, auxiliary materials semi-products. Control of material goods by enterprise executives, information provided to auditors. With internal control we can find the exact cost of the reserves, the exact cost of the goods sold and we can accurately determine the amount they are in the warehouse. Through accurate records, the true amount of material goods is determined, eliminating doubt about the valuation of the material goods that are in stock. Reports accepted the auditors for the status of material goods at the warehouse, analyzed the handling method, the form of records, the accuracy of the data, the stocks are the property of the enterprise or remain or are mortgaged or mixed or damaged, measuring accuracy and material assets, the stock part of the balance sheet. The auditor should ensure that all necessary actions for the stocks held by the enterprise are recorded until the closing of the books, stocks are the most important balance sheet items, the role of reserve control is very important

Keywords: Reserves, Controls, Evaluations and Assessment Methods.

REZERVAT DHE KOSTOJA E MALLIT TE SHITUR**Blerim Shehu**

VTC Prizren, Kosovo, bshehu76@hotmail.com

Abstrakt: Kjo temë trajton rolin e rezervave të mirave materiale që janë në depo, keto të mira janë në formë të produkteve të gatshme, gjysme produkteve materialit ndihmes. Kontrolli i të mirave materiale nga drejtorët e ndërmarrjes, informatat të cilat ofrohen për revizorët. Me anën e kontrollit të brendshëm mund të zbulojmë koston e saktë të rezervave, koston e saktë të mallrave të shitur si dhe mund të përcaktojmë saktë sasinë e tyre që gjenden në depo. Përmes regjistrimeve të sakta përcaktohet sasia reale e të mirave materiale, eliminon dyshimet mbi vlerësimin e të mirave materiale që janë në depo. Raportet e pranuar revizoret për gjendjen e të mirave materiale në depo, analizojnë mënyren e trajtimit, formën e regjistrimeve, saktësinë e regjistrimeve, stoqet a janë pronë e ndërmarrjes apo janë të lëna hipotekë apo janë të përziera apo me defekte, matja e saktësisë e të mirave materiale, pjesëmarrja e stoqeve në bilancin kontabël. Revizori duhet të sigurojnë se janë regjistruar të gjitha veprimet e nevojshme për rezervat që disponon ndërmarrja deri në mbylljen e librave, rezervat janë zëra shumë i rëndësishëm i bilancit kontabel, roli i kontrollit të rezervave është shumë i rëndësishëm

Fjalët kyçe: Rezervat, Kontrolli, Saktësia dhe Metodat e vlerësimit.

1. PËRGJEGJËSIT E REVIZORËVE NË LIDHJE ME REZERVAT OSE STOQET NE DEPO

Në vitet e 30 të shekullit 20 përgjegjësit e revizorëve në lidhje me rezervat kufizoheshin vetëm në trajtimin dhe analizën e të dhënave kontabile, mbizotronte bindja se revizorët nuk kanë aftësitë e duhura që të kryejnë çfarëdo lloj matje shkencore dhe fizike të rezervave, dmth të zbulojnë dhe të matin shumëllojshmërinë e lëndëve të para dhe ndihmese që gjenden në depo, në fabrikë dhe në ndërtesa të tjera të klientëve të tyre. Kjo bëri që të ketë shkelje të mëdha nga ndërmarrjet dhe të kalojnë pa u konstatuar nga revizorët e pavarur. Kështu u zbuluan ndërmarrje industriale që paraqisnin elemente pasurore fiktive, që mbanin rezerva në shumë kolosale inegzistente.

Me qëllim që të shmangëshin shkeljet e mësipërme u desh të hidhen poshtë konceptet e ngushta në lidhje me përgjegjësinë e revizorëve, të formuloheshin dhe të pranoheshin standarde të reja të cilët ngarkonin revizorët të analizojnë gjendjen fizike të rezervave.

Këto koncepte të reja u miratuan nga anëtarët e institutit Amerikanë të ekspertëve Kontabël(IAEK). Botuan dy qarkore mbi standardet e kontroll-revizonit, të cilat theksonin rëndësinë e inventarit real që duhet të kryejnë revizorët, ndërsa u miratuan procedura të tjera kontrolluese në kushtet të reja.

Qarkoret kishin lidhje me:

Bizneset të cilat mbanin të dhëna kontabile analitike dhe të sakta(libër magazine) për përcaktimin e sasisë së rezervave dhe

Biznese që ndiqnin vetem inventar vjetor për përcaktimin e sasisë së rezervave.

2. PËRKUFIZIMI I REZERVAVE

Mund të japim dy përkufizime në lidhje me rezervat

Rezervat janë sasia e depotizuar e një të mire me qëllim që të përballohet kërkesa për të në të ardhmen.

Rezervat janë elemente pasurore qarkulluese të ndërmarrjes që do të shiten në kuadrin e veprimtarisë së ndërmarrjes.

Koncepti rezervave përfshin të mirat e gatshme për shitje që gjenden në duart e ndërmarrjes

- Të mira gjysmë të përpunuara
- Materiale të para dhe
- Materiale ndihmëse.

3. PËRSE REVIZORËT U JAPIN RËNDËSI TË MADHE REZERVAVE

Revizorët u japin rëndësi të madhe rezervave sepse janë elementi më i rëndësishëm i aktivitetit në bilancin kontabël të ndërmarrjes dhe që zënë peshë të madhe në gabimet e bëra, në krahasim me çdo element tjetër pasurore. Revizorët u japin rëndësi të mëdha rezervave sepse çmimet e tyre paraqesin shpesh luhatje të mëdha dhe kjo për shkak të ndryshimeve inflacioniste të çmimeve që mund të sjellin rreziqe për ndërmarrjen.

Gjithashtu, ndërmarrja tregon interes për vlerën e rezervave sepse kjo ndikon në koston e produkteve të shitura si dhe në fitimin vjetor neto.

Përpjekjet që bëjmë për përcaktimin dhe saktësimin e sasisë dhe vlerës së rezervave janë më të vështira dhe më komplekse, në qoftë se do t'i krahasojmë me përpjekjet që bëjmë për të përcaktuar dhe saktësuar të dhënat të tjera të pasqyrave financiare.

4. OBJEKTIVAT E REVIZORËVE GJATË ANALIZËS SË REZERVAVE

Objektivat e revizorëve gjatë analizës së rezervave janë:

të përcaktojnë nëse ekziston sasia e plotë e rezervave,

të përcaktojnë dhe të kontrollojnë cilësinë dhe gjendjen e rezervave

të përcaktojnë metodën më të përshtatshme për vlerësimin e rezervave dhe

të shikojë nëse ekziston pronësia mbi rezervat.

Analiza e rezervave nga ana e revizorëve synon në zbulimin e mundshëm të shumës së gabuar qëllimisht të rezervave, shkeljet në zbulimin e gabimeve të rastit si dhe në përcaktimin e vlerës dhe sasisë së saktë të tyre.

5. RËNDËSIA E KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË REZERVAVE DHE I KOSTOS SË TË MIRAVE MATERIAL TË SHITURA

Siç e pamë edhe më parë, kontrolli i brendshëm synon kryesisht në zbulimin e shkeljeve dhe në shmangien e shpërdorimeve. Por kontrolli i brendshëm kryen edhe funksione të tjera, të cilat janë shumë më të rëndësishme sesa shkeljet. Me anën e kontrollit të brendshëm mund të zbulojmë koston e saktë të rezervave, koston e saktë të mallrave të shitur si dhe mund të përcaktojmë saktë sasinë e tyre gjendje në depo.

Kontrollet e plota të brendshme kontribuojnë në shmangien e të dhënave të gabuara mbi koston, të cilat përdoren nga drejtorja e ndërmarrjes gjatë marrjes së vendimeve dhe të caktimit të çmimeve. Pra, në realitet kërkohet një pamje reale e rezervave përmes llogarive. Kështu, pasqyrat financiare do të jenë të besueshme përse i përket fitimit dhe pasurisë reale të firmës.

Gjithashtu kontrolli që bëjmë mbi rezervat dhe koston e mallrave të shitura është i rëndësishëm, sepse prek pothuajse të gjitha funksionet e tjera kontabile, të cilat kanë lidhje me prodhimin dhe shitjen e produkteve.

6. FUNKSIONI I FURNIZIMIT, MARRJES NË DORËZIM, MAGAZINIMIT, NDARJES, PËRPUNIMIT DHE DËRGIMIT NË DESTINACION

Për furnizimet përgatit "urdhërblertje" e limituar. Më pas dërgojmë kopjen e tyre në dy zyra të tjera, në drejtorinë e furnizimit dhe drejtorinë e konatbilitetit.

a) Funkcioni i marrjes në dorëzim

Personi që merr në dorëzim të mirat, të cilat vijnë nga furnizimet jashtë ndërmarrjes, është kopetente dhe mban përgjegjësi: për sasinë e të mirave që mungojnë, për zbulimin e produkteve defekte, për transferimin e të mirave të marra në dorëzim në ruajtje, brenda një kohë sa më të shkurtër dhe për përpilimin e raportit për marrjen në dorëzim.

b) Funkcioni i magazinimit

Kur të mirat mbërrijnë në depo, personi përgjegjës i merr në dorëzim, duke i numëruar apo peshuar ato. Më pas, drejtorja e furnizimeve azhuron drejtorinë e konatbilitetit në lidhje me sasinë e marrë në dorëzim dhe të magazinuar në fletë hyrje, në vazhdim personi përgjegjës nënshkruan për marrjen në dorëzim të të mirave dhe i merr ato nën përgjegjësinë e vet.

c) Funkcioni i shpërndarjes

Meqenëse magazinieri është personi përgjegjës për të mirat që zotëron, duhet të kërkojë nga personat që do të furnizohen që të jenë të pajisur me një fletëkërkesë të posaçme, e cila do të shoqërohet me pas nga një fletëdalje

e nënshkruar nga sektori që merr në dorëzim të mirat. Nga një kopje e mban drejtorja ose departamenti që bën kërkesë, magazinieri dhe një shërbimi kontabël.

d) Funksioni i përpunimit industrial

Gjatë përpunimit të të mirave në fabrikë dhe para se ato të depozitohen si produkte të gatshme, duhet të ketë një person të autorizuar, i cili duhet të dijë se ku gjenden produktet dhe si do të shpërndahen ato.

Kontrolli i brendshëm i të mirave që gjenden në fazën e përpunimit përfshin kontroll cilësor të të mirave, me qëllim që të zbulohen ato me defekte dhe jashtë standardit, duke i hequr nga procesi i prodhimit.

e) Funksioni i shitjes

Shpërndarja e të mirave duhet të bëhet pas miratimit nga drejtori apo departamenti i shitjeve. Një kopje e grafikut të miratuar mbi shitjet ose shpërndarjen i dërgohet përgjegjësit të depove dhe një kopje tjetër mbahet nga vetë ajo. Porsa të mirat të ngarkohen në mjetet e transportit, pritët fatura nga ana e zyrës së përpilimit të faturave.

7. SISTEMI I LLOGARITJEVE

Sistemi i llogaritjeve është pjesë e pandarë e kontrollit të brendshëm të rezervave dhe shërben për shpërndarjen e kostos së lëndëve të para dhe ndihmëse, kostos së punës dhe kostos së tërthortë. Ai përmban informacione të sakta dhe të besueshme për vlerësimin e rezervave dhe është një mjet mbrojtës për elementet pasurore të ndërmarrjes.

Sistemi i inventarit të vazhdueshëm të rezervave - tregojnë sasinë e të mirave që gjenden në duart e ndërmarrjes. Ky inventar na jep informacione mbi shitjet dhe prodhimin dhe që përbëjnë pjesën më të rëndësishme të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Kontrolli i brendshëm dhe kompjuteri - me anë të kompjuterit mund të arrijmë inventarin e vazhdueshëm të rezervave, madje sa më shpesh nëse deshiron, Me këtë metodë kemi vlerësim të rezervave të ndërmarrjes në çdo moment. Përmes kompjuterit mund të arrihet një analizë e plotë për çdo të mirë të magazinuar, mandje edhe kur kemi numër shumë të madh të artikujve.

Fletat e punës përgatiten nga revizorët kur kontrollojnë rezervat dhe koston e të mirave të shitura. Ato përmbajnë komente me shkrim dhe analizë të hollësishme e llogaritjeve të ndryshme, duke treguar se si u krye inventarizimi fizik.

8. ÇËSHTJE QË ANALIZOHEN NGA REVIZORËT GJATË KONTROLLIT ANALITIK

Revizorët gjatë kontrollit të brendshëm marrin pjesë në procedurat, furnizimet, marrjen në dorëzim, shpërndarjen e të mirave dhe kontrollin mbi prodhimin si dhe në sistemin e llogaritjes dhe të inventarit të vazhdueshëm të rezervave. Ata duhet të marrin masat e nevojshme për mbrojtjen fizike të rezervave dhe për këtë duhet të shikojnë nëse ka mangësi në ndërtesat ku bëhet magazinimi i produkteve, përndryshe do të kishte pasoja të drejtpërdrejta në të për shkak zjarresh, vjedhjesh, apo kushtesh të këqija atmosferike.

Gjatë trajtimit të hollësishëm të kontrollit të brendshëm revizorët analizojnë:

Nëse për çdo kategori të mirash materiale mbahet veçmas inventar i vazhdueshëm për rezervat.

Nëse të dhënat e inventarit të vazhdueshëm për rezervat ballafaqohen me inventarizimin fizik, të paktën një herë në vit.

Nëse përdoren etiketa me numra për inventarizim fizik, të rezervave.

Nëse ekziston një drejtori apo departament i pavarur për furnizimet, i cili ndjek të gjitha furnizimet dhe refuzimin e të mirave materiale që nuk plotësojnë kushtet e kontratës.

9. KONTROLLI I SISTEMIT TË LLOGARITJES SË KOSTOS

Dimë që elementet bazë që përbëjnë koston e produkteve janë tri:

- Kostoja e drejtpërdrejtë e lëndës së parë
- Kostoja e drejtpërdrejtë e punës
- Shpenzimet e përgjithshme

Sistemet e llogaritjes së kostos kanë për objektiv akumulimin e kostos reale ose të kostos standarde në qendrat e kostos dhe prej andej në shpërndarjen e tij sipas produkteve. Kështu, kontrolli që kryhet nga revizorët mbi sistemin e llogaritjes së kostos duhet të synoj dhe të përcaktojë nëse kostoja është shpërndarë drejt dhe me koeficientë të saktë sipas qendrave të kostos.

10. KONTROLLET THELBËSORE

a) Nga kush kryhet inventarizimi fizik i rezervave – që të arrihet kontrolli i saktë mbi rezervat kërkohet caktimi i një nëpunësi nga ana e drejtorisë së ndërmarrjes që kontrollohet, i cili do të jetë përgjegjës drejtpërdrejt për inventarin fizik. Ky nëpunës mund të jetë përfaqësues i drejtorit të shërbimeve ekonomike ose përgjegjësi i kontabilitetit të prodhimit

b) Çfarë përfshin planizimi –

- Zgjidhet dita më e përshtatshme se kur do të kryhen inventarizimi fizik.
- Bëhen përpjekje për të pakësuar sa të jetë e mundur sasinë e të mirave që gjenden në përpunim
- Jepen shpjegime se cilat janë arsytet e mbylljes së departamenteve të prodhimit të fabrikës gjatë kryerjes së inventarizimit.
- Veçohen produktet me difekte
- Jepen udhëzime me shkrim të gjithë personave që do të marrin pjesë në inventar.
- Matrikulohen pra u vihet nga një numër të gjitha etiketave të rezervave.
- Planzohet se si do të klasifikohen për efekt të kontrollit të mirat që prodhohen gjatë inventarit.

Revizori përgjegjës përcakton se kur do të bëhen matjet, sa revizor do të marrin pjesë në çdo depo dhe sa kohë do të kërket për të përfunduar inventarizimin.

c) Analiza e inventarit të rezervave dhe kryerja e kontrollit të matjeve – inventari i rezervave kryhet, kontrollohet dhe mbikëqyret nga drejtoria dhe jo nga revizorët. Revizorët analizojnë se si bëhet kontrolli dhe qëllimi bazë i tyre është grumbullimi i të dhënave që do të vërtetojnë ekzistencën dhe qenien në pronësi ose jo të rezervave nga ana e ndërmarrjes që ata kontrollojnë, pra revizorët analizojnë nëse realisht janë të besueshme sasitë e rezervave që paraqitet drejtoria e ndërmarrje.

d) Si kryhet inventarizimi – të mirat materiale i ndajmë në grupe të ndryshme dhe në secilin grup të mirash materiale vendosim një etiketë me numër që përshkruan karakteristikat e produktit, kjo bëhet për të mos gabuar që të numërohet dy herë. Vendosja e etiketave dhe klasifikimi bëhen nga nëpunësit e ndërmarrjes. Më pas revizorët duhet të paraqesin në fletët e punës numrat me të dhënat e produkteve të marra nga etiketat. Revizorët krahasojnë etiketat e inventarit me matjet e inventarit dhe përpiqen të zbulojnë gabimet e mundshme. Nëse vërehen gabime të mëdha, fillon një inventarizim i ri për të gjitha rezervat.

e) Verifikimi i rezervave kur revizorët angazhohen me inventarin pas fundit të vitit – shumë herë revizorët nuk mund të analizojnë inventarin gjatë mbylles së vitit, por para ose pas fundit. Por kryesisht revizorët duhet të jenë në kontakt të drejtpërdrejt me rezervat.

f) Të mirat materiale në ruajtje – gjatë analizës së rezervave revizorët duhet të sigurohen dhe të bëjnë kontrolle se të mirat materiale që gjenden në duart e ndërmarrjes janë pronë e saj apo u takojnë të tretëve si bankës, doganave etj.

g) Si të verifikohet ekzistenca e të mirave materiale që gjenden në depot e përbashkët dhe për të mirat e dhëna në ruajtje - kur shuma e rezervave përfaqëson një përqindje të konsiderueshme të aktivitetit qarkullues, atëherë nuk është e mjaftueshme analiza e dokumenteve që vërtetojnë marrjen në dorëzim në magazinë të stoqeve është mirë të verifikohet edhe sasia e tyre që është magazinuar në magazinat e përbashkëta.

h) Përcaktimi i cilësisë së rezervave - kur revizorët nuk janë të azhurnuar në lidhje me cilësinë e rezervave, mund t'i drejtohen një personi me përvojë i cili është në gjendje të përcaktojë nëse cilësia e rezervave është e dyshimtë.

i) Përcaktimi i saktësisë së matjeve – gjatë inventarizimit të rezervave duhet të bëhet kontrolli i veprimtarive aritmetike. Zakonisht burimet e gabimeve janë gabimi në përcaktimin e peshës ose shumëzim i gabuar i sasisë me çmimin, gabim mund të bëhet edhe në transferimin e shumave nga njëra faqe në tjetrën.

j) Analiza e metodave dhe teknikave të vlerësimit të rezervave - revizorët janë përgjegjës drejtpërdrejt për të përcaktuar nëse metodat dhe teknikat e vlerësimit të rezervave përputhen me parimet e pranura të kontabilitetit.

- së pari të shikojnë çfarë metode vlerësimi përdor klienti në lidhje me rezervat ose stoqet d.m.th. nëse ai përdor metodën e kostos historike, çmimin korent të tregut, metodën e çmimit të shitjes me pakicë apo çmim bursier. Metoda e kostos përfshin këto metoda të veçanta vlerësimi: Lifo, Fifo, koston aritmetike të thejstë dhe të përbërë dhe koston standard.

- të analizojnë nëse metodat e vlerësimit janë të njejta me ato të përdorura vitet e kaluara. Nëse ndryshon metoda e vlerësimit të rezervave, të dhënat duhet të konvertohen, të analizohen përpasitë dhe mangësit e aplikimit të metodës se re dhe natyrisht të bëhet ndonjë referencë në relacionin e bilancit kontabël. Gjithashtu duhet të llogaritet rezultati që del nga ndryshimi i metodës së vlerësimit.

- të analizojnë nëse metoda që është zgjedhur është zbatuar me kosekuencë në praktikë. Për këtë revizorët duhet të kontrollojnë vlerësimin e një numri konkret të mirash materiale. Revizorët kryejnë kontrolle vlerësimi në disa të mira materiale të përzgjedhura përfundimtare ose në përpunim. Mund të përdoret edhe metoda e mostrave, sipas mënyrës rastësore.

Kontrolli i rezervave fillestare gjatë kontrollit të një klienti relativisht të ri – revizorët duhet të analizojnë nëse një klient i ri u kontrollua vitet e kaluara nga ekspertetë të tjerë kontabël. Në qoftë se do të dëshmohej se klienti i ri është i edukuar me parimet e kontabilitetit, atëherë do të bëhet një kontroll i pjesshëm në rezervat fillestare. Do të kontrollohen metodat e vlerësimit, do të analizohen të dhënat e rezervave dhe fletët e inventarit të mëparshëm.

Si dhe përse analizojmë koston e të mirave materiale të shitura - gabimet që bëhen në koston e të mirave materiale të shitura kanë lidhje me gabime në përcaktimin e gjendjes së rezervave në fillim dhe në fund të periudhës ushtrimore si dhe me gabime në të dhënat e kontabile të blerjeve, të cilat ndikojnë përfundimisht në rezultatin e vitit ushtrimor dhe për rrjedhim edhe në tatimin mbi fitimin. Revizorët që të sigurohen nga e tyre se nuk ka mangësi serioze, duhet të analizojnë të gjitha llogaritë e Librit të madh. Analiza e koston së produkteve të shitura në një ndërmarrje industriale paraqitet mjaft e vështirë. Prandaj, revizorët duhet të kërkojnë një analizë të koston për çdo muaj në lidhje me lëndët e para, punën drejtpërdrejtë dhe shpenzimet e përgjithshme. Nëse sistemi i llogaritjes së koston që aplikohet është i drejtë, revizorët bëjnë vetëm kontrollet e domosdoshme, ndërsa në qoftë se nuk mbahet drejt ai, bëhen kontrolle të hollësishme me qëllim që të verifikohet nëse bëhet kalkulimi i saktë i koston së të mirave materiale të shitura.

- Si mund ta dimë nëse rezervat janë dhënë për hipotekim – nëse ka të mira materiale të vëna hipotekim për të siguruar kredinë bankare, kjo do të bëhet e qartë kur të gjenden teprcat bankare dhe detyrimet e tjera për kreditë e marra.

Rezervat në bilancin kontabël dhe të koston së të mirave materiale të shitura në llogarinë “Fitime dhe humbje”- mënyra më e mirë për të paraqitur rezervat në pasqyrat financiare është të referojmë se cila metodë vlerësimi është përdorur për to. Meqëse rezervat mund të vlerësohen me metoda të ndryshme, për këtë arsye do të përcaktojmë metodën përkatës. Kështu fitimi mund të varet përdorimi herë i metodës Fifo dhe herë metodës Lifo.

Kur paraqiten rezervat në pasqyrat financiare duhet bërë kujdes në lidhje me:

- ndryshimin e rastit në metodat e vlerësimit të rezervave
- Me klasifikimin e rezervave në këto kategori: produkte të gatshme, produktet që gjenden në fazën e përpunimit, lëndë të para, lëndë ndihmëse, lëndë të para dhe ndihmëse në udhëtim.

PËRMBLEDHJE

Rezervat e të mirave materiale që i disponon ndërmarrja dhe roli i kontrollit të këtyrë të mirave materiale përbën një nga problemet dhe momentet më të rëndësishme të kontrollit- revizionit. Revizorët u japin rëndësi të madhe rezervave sepse janë elementi më i rëndësishëm i aktivitetit në bilancin kontabël të ndërmarrjes, zënë peshë të madhe, në krahasim me çdo element tjetër pasurorë. Revizorët u japin rëndësi të mëdha rezervave sepse çmimet e tyre paraqesin shpesh luhatje të mëdha dhe kjo për shkak të ndryshimeve inflacioniste të çmimeve që mund të sjellin rreziqe për ndërmarrjen.

Gjithashtu, ndërmarrja dhe menaxhmenti i saj tregojnë interes shumë të madh për vlerën e rezervave sepse kjo ndikon në koston e produkteve të shitura si dhe në fitimin vjetor neto.

Përpjekjet që bëjmë për përcaktimin dhe saktësimin e sasisë dhe vlerës së rezervave janë më të vështirat dhe më komplekset, në qoftë se do t'i krahasojmë me përpjekjet që bëjmë për të përcaktuar dhe saktësuar të dhënat të tjera të pasqyrave financiare.

Me rëndësi është trajtimi i saktësisë, sistemi i llogaritjeve, konsistenca e metodave vlerësuese që është shumë më rëndësi se nga kjo mund të përcaktohet kostoja e mallit të shitur, fitimi, tatimet.

LITERATURA

- [1] Brown, Stickney, Whalen “Financial Statement Analysis” eight edition.
- [2] Dhimiter, N., Karapici, V., Peta, E., (2003) “Auditimi” Tiranë, Albania
- [3] Dhimiter, N., Karapici, V., Peta, E., (2007) “Aditmi” SH.B. Libri Universitar Tiranë, Albania
- [4] Halit, X., “ Analiza e pasqyrave Financiare” botim i parë
- [5] Sotiraq, D., “ Kontabiliteti I avancuar” botim I dytë
- [6] Wiliam F. Messier Jr, (2007) DBA, CPA, Auditing, McGRAW HILL, INC, (anglisht-kroatisht), Zagreb
- [7] Zager, L., Tusek, B., Barisic, I., (2014) “Interna Revizija” Zagreb
- [8] <http://www.freebookcentre.net/Business/Accounting-Books.html>,